



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, nenin 21, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëri Tregtare, Statutin e Ndërmarrjes Publike Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.A., si dhe Kodit të Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2026 miraton:



RREGULLOREN Nr.02/2026 PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË UJITJES

PRISHTINË, MARS 2026

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

- (1) N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A., ofron ujin për ujitje për nevoja të fermerëve në tri fushat kryesore (Kosova Veriore I, Kosova Veriore II dhe Fusha e Drenicës), me rënie të lirë (gravitacion) apo përmes pompimit (Stacioneve Pompike).
- (2) N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A., iu ofron fermerëve pajisjet për ujitje apo lateral (me pajisje apo lateral nënkuptohet kompleti i gypave të aluminit së bashku me lidhëse, spërkatës, mbyllës dhe çelës të hidrantit të numëruara në specifika) në shfrytëzim, me kontratë.
- (3) Duke shfrytëzuar ujin dhe mjetet që disponon N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A., ndërmer të gjitha aktivitetet që të ofroj ujin për ujitje fermerëve gjatë tërë sezonës së ujitjes.
- (4) Çmimi i shërbimeve për fermerët individual apo Shoqata caktohet nga Bordi i Drejtorëve i N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A.
- (5) Për marrjen e shërbimeve të ujit për ujitje apo pajisjeve të ujitjes, fermerët apo Shoqatat duhet të kontraktojnë me Ndërmarrjen brenda afatit të caktuar.
- (6) Fermerët që nuk lidhin kontrate me Ndërmarrjen, konsiderohen si shfrytëzues ilegal dhe do të paditen nga Ndërmarrja.
- (7) Fermerët që nuk kontraktojnë brenda afatit të caktuar do të trajtohen ndryshe dhe paguajnë çmim 50% më të lartë se kontraktuesit e rregullt.
- (8) Kontratat e ujitjes aprovohen dhe nënshkruhen nga personi i autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A., me të cilën rregullohen obligimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese.
- (9) Me qëllim të mbështetjes së Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (SHPU), Ndërmarrja ofron çmim më të ulët duke i obliguar SHPU-të, të bëjnë pagesën totale për të gjithë anëtarët e vet.
- (10) Çdo lidhje, ndërtim, instalim apo adaptim i pa autorizuar në rrjet, pajisje apo kanal të Ndërmarrjes është ilegal, dhe kundër ndërhyrësit do të ngritët padi nga Ndërmarrja.

Neni 2

Mbushja dhe vënia e sistemit në funksion

- (1) Sistemi i ujitjes do të vihet në funksion sipas kërkesave të fermerëve dhe kushteve specifike klimatike për vitin përkatës.

- (2) Mbushja e sistemit për ujitje parimisht fillon nga 01.06. dhe zgjatë deri me 30.09. të vitit kalendarik, me mundësi të vazhdimit, varësisht nga kushtet klimatike dhe mundësive të ndërmarrjes.
- (3) Përrjashtimisht nga paragrafi paraprak, sistemi i ujitjes do të vihet në funksion edhe më herët në bazë të kërkesave të shfrytëzuesve dhe kushteve specifike klimatike.
- (4) N.P.H. "Ibër Lepenc"Sh.A., nuk do të vejë në funksion rrjetin apo pjesë të tij (nënsisteme) në rastet kur:
 1. Mungon uji;
 2. Dëmet në rrjet dhe pajime janë të mëdha/të pa-riparueshme për sezonin përkatës;
 3. Mungojnë mjetet për riparimin e dëmeve të mëdha;
 4. Mungon rryma elektrike për Stacionet Pompikë;
 5. Ka dëmtime në rrjet apo pajime nga vet fermerët.
- (5) Për rastet e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, Ndërmarrja nuk merr përgjegjësi apo obligime eventuale për kompensimin e fitimit të humbur ndaj shfrytëzuesve që kanë kontraktuar me Ndërmarrjen.
- (6) Nëse ujitja nuk realizohet si rrjedhojë e rasteve të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, Ndërmarrja, më së voni deri më 30. 07. të vitit vijues, kontraktuesve të sajë u kthen pagesën e bërë avans me rastin e kontraktimit, duke shtuar edhe kamatën bankare për mjetet në llogari rrjedhëse, pa destinim të caktuar.

Neni 3 **Kontraktimi i pajisjeve**

- (1) Pajisjet për ujitje do t'i marrin fermerët, që shfrytëzojnë sistemin e ujitjes dhe që dëshmojnë me fletë poseduese, kontratë për qiramarrje apo dokument tjetër se:
 1. Kanë kontraktuar ujitjen e së paku 3,5 ha;
 2. Janë kontraktues të rregullt dhe
 3. Nuk kanë obligime të pa shlyera më shumë se për një sezon.
- (2) Fermerët që nuk e përmbushin kriterin e 3,5 ha, si kusht për marrjen e pajisjeve, mund të grupohen dhe të nënshkruajnë kontratë të përbashkët, duke i përfaqësuar njëri nga ta.
- (3) Fermerët që nuk posedojnë 3,5 ha tokë por dëshirojnë të marrin pajisjet, mund ta bëjnë këtë nëse paguajnë shërbimet e ujitjes për sipërfaqen prej 3,5 ha.
- (4) Fermerët që nuk vazhdojnë kontraktimin për vitin vijues, obligohen t'i kthejnë pajisjet jo me larg se me datë 31 Mars të vitit vijues, në të kundërtën do të trajtohet se kanë vazhduar, në heshtje, kontraktimin edhe për vitin vijues dhe do të jenë të detyruar të paguajnë në emër të ujitjes për sipërfaqet proporcionale me pajisjet e pa kthyer.

- (5) Për fermerët që vitet e kaluara nuk i janë përmbajtur kontratave për ujitje dhe pajisje, në rast të kontraktimit, të paguajnë në total kontratën vijuese.
- (6) Obligimet kontraktuese rregullohen me kontratë për marrjen e pajisjeve e që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4 Kontraktimi i ujitjes

- (1) Ujitjen e tokës bujqësore mund ta kontraktojnë të gjithë ata që kanë tokë në pronësi, apo të marrë me qera në territorin ku shtrihet rrjeti i ujitjes së Ndërmarrjes.
- (2) Nuk mund të kontraktohen sipërfaqet jashtë sistemit dhe ato që nuk janë të rehabilituara.
- (3) Kontraktim i afatshëm konsiderohet çdo kontraktim deri me 31.07. të vitit vijues.
- (4) Kontraktim i jashtëafatshëm konsiderohet çdo kontraktim pas 31.07 për vitin vijues, me përjashtim të kontraktimit për ujitjen e paskulturave (kulturave të dyta).
- (5) Fermerët të cilët nuk i kanë ujitur sipërfaqet e kontraktuara me fajin e tyre, janë të obliguar t'i përmbushin obligimet sipas kontratës së ujitjes.
- (6) Të gjithë ujitësit pa kontratë konsiderohen si ujitës ilegal.

Neni 5 Evidentimi i sipërfaqeve

- (1) N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A, do të evidentoj me procesverbal të gjitha sipërfaqet që ujiten, pavarësisht se janë kontraktuar apo jo.
- (2) Gjithashtu do të evidentohen edhe ujitjet e përsëritura, me qëllim të marrjes së informatave për numrin e ujitjeve dhe sasinë e ujit të shpenzuar.
- (3) Evidentimi bëhet nga personat e autorizuar të Ndërmarrjes në prani të shfrytëzuesit të cilët janë të obliguar të nënshkruajnë procesverbalin e evidentimit
- (4) Në rast refuzimi të fermerit që të nënshkruaj procesverbalin, i njëjti nënshkruhet nga personi i autorizuar i Ndërmarrjes duke konstatuar arsyen e mos nënshkrimit dhe kjo krijon obligime për fermerin.
- (5) Ndërmarrja obligohet që të bëjë inspektime sezonale për konstatimin e ujitjes ilegale.
- (6) Në rast se gjatë këtyre inspektimeve konstatohen ujitje ilegale, veprohet në përputhje me paragrafin 5 të Nenit 6 të kësaj rregulloreje.
- (7) Fermerët të cilët identifikohen që ujin ilegalisht nuk përfshihen në marrëveshjet me komunat për subvencionimin e ujitjes për vitin aktual.

Neni 6 Çmimi dhe mënyra e pagesës

- (1) Çmimi caktohet nga Menaxhmenti i Ndërmarrjes dhe aprohet nga Bordi i Drejtorëve, për secilin vit apo sezon me propozim të KE të Ndërmarrjes, me të cilin informohen të gjithë fermerët e sistemit, me rastin e kontraktimit.
- (2) Mënyra dhe kushtet e pagesës së shërbimeve për një sezon rregullohen me kontratë dhe dallojnë varësisht nga sipërfaqet e kontraktuara, kontraktimit individual apo përmes Shoqatës së Përdoruesve të Ujit (SHPU).
- (3) Mënyra e pagesës është si në vijim:
 1. Deri në 0,5 ha, pagesa e tërësishme me rastin e kontraktimit;
 2. Prej 0,5 deri 3,5 ha, 50% me kontraktim dhe 50% deri në fund të vitit kontraktues;
 3. Mbi 3,5 ha, 30% me rastin e kontraktimit, ndërsa 70% deri në fund të vitit kontraktues;
 4. Kontratat e jashtafatshme dhe kontraktuesit që kanë obligime paraprake, këtu përfshihen edhe parcelat me borxhe paraprake, paguajnë 100% me rastin e kontraktimit;
 5. Fermerët ilegal dhe ata të cilët nuk i kthejnë pajisjet e ujitjes dhe nuk kanë lidhë kontratë të veçanet për vitin aktual(neni 3 parag.4) do të paguajnë 50% më shumë se çmimi i plotë.
 6. Në rast të vonesës me pagesë atëherë borxhit kryesor, i shtohet edhe kamata ligjore, duke llogaritur nga dita e parë e vonesës deri në ditën e pagesës
 7. Në rast se fermerët nuk ju përmbahen detyrimeve të tyre, ndërmarrja gëzon të drejtën për iniciimin e procedurave me qëllim të realizimit të interesave të ndërmarrjes përkatësisht inkasimin e borxheve.
- (4) Kontraktimi dhe mënyra e pagesës për SHPU-t, do të konsiderohet si shitje me shumicë e shërbimeve, prandaj çmimi, mënyra e pagesës dhe kontraktimi do të rregullohen me kontratë të veçantë.
- (5) Me rastin e nënshkrimit të Kontratës për shfrytëzimin e ujitjes çdo fermer do të njoftohet me dispozitat e Rregullores për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes.

Neni 7
Marrëveshjet me Komunat për subvencionimin e ujitjes

- (1) Kryeshefi Ekzekutive mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me komunat nëpër të cilat shtrihet sistemi i ujitjes për subvencionimin e fermerëve për ujitjen e tokave bujqësorë.
- (2) Në rast të tejkalimit të sipërfaqeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr vendim për lirim nga pagesa ose merr përsipër të sigurojë buxhet shtesë për të gjithë fermerët që kanë kontrata për ujitje (duke mos i faturuar), me qëllim të trajtimit të barabartë për të gjithë fermerët.

Neni 8
Hyrja në fuqi

- (1) Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Shfrytëzimin e Sistemit të Ujitjes Nr.01-4342, e datës 30.12.2014.
- (2) Pjese përbërës e kësaj rregulloreje janë: Kontrata për Ujitje, Kontrata për Shfrytëzimin e Pajisjeve Mobile për Ujitje dhe Procesverbali.




Bajram MUSTAFA
Kryesues i Bordit të Drejtorëve

NPH "Ibër Lepenc" Sh.A



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

_____ nga _____
(Emri (Emri i prindit) dhe Mbiemri) (vendbanimi dhe adresa)

I.nj _____ Pronar apo shfrytëzues ligjor i tokës; Komuna kadastrale _____

NIF (Numri Identifikues i Fermerit) _____

(Fermeri),

Në bazë të dispozitave të nenit 1 dhe 4 të Rregullores për Shfrytëzimin e Sistemit të Ujitjes, lidhin:

KONTRATË PËR UJITJE

I

Objekt i kontratës është shitja respektivisht blerja e shërbimeve të ujitjes të tokës bujqësore.

II

Detyrimet e Ndërmarrjes

Ndërmarrja detyrohet që fermerit t'i siguroj shërbime cilësore të cilat nënkuptojnë sasi dhe shtypje të mjaftueshme si dhe shërbime me kohë për ujitjen e kulturave bujqësore, gjatë sezonës së ujitjes, për sipërfaqet:

Zona kadastrale	Ngastra nr.	S.P/Fusha	Tubacioni	Kultura	Sipërfaqja
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____
Gjithsejtë:					ha _____

Në rast të kërkesave të arsyeshme të fermerëve, Ndërmarrja obligohet të ofroj shërbimet e veta edhe jashtë sezonës së ujitjes, gjegjësisht edhe para datës 01.06 siç është precizuar në "Rregulloren për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes", pjesë e të cilit është edhe kjo kontratë.

Në rast të mos mbushjes së sistemit për shkak të defekteve të mëdha, mungesës së rrymës, mungesës së ujit etj, sipas nenit 2.4.të Rregullores,

Ndërmarrja detyrohet që shfrytëzuesit t'ia kthej pagesën e bërë me rastin e kontraktimit.

Çmimi i ujitjes është 140 €/ha për vit.

III Detyrimet e fermerit

Fermeri para fillimit të ujitjes duhet ta njoftoj Ndërmarrjen me qëllim evidentimi, për:

- Fillimin e ujitjes
- Përfundimin e ujitjes

Me rastin e evidentimit të sipërfaqeve të ujitura, fermeri apo i autorizuari i tij, duhet të asistoj në procesin e evidentimit.

Në rast se fermeri për shkaqe objektive apo nuk dëshiron të jetë prezent me rastin e evidentimit, i njëjti pranon gjendjen e konstatuar me procesverbalin nga evidentuesi i Ndërmarrjes.

Fermeri me rastin e kontraktimit të _____ ha, pagoi _____ €, që është _____ % e çmimit të plotë, kurse pjesën tjetër prej _____ € ose _____ %, do ta paguaj deri me 31. 12. të vitit kontraktues.

Fermeri, pagesën e ujitjes mund ta bëjë në llogari bankare, në arkën e ndërmarrjes ose punëtorit të autorizuar të Ndërmarrjes në Njësinë Punuese.

Në rast të vonesës së pagesës, fermeri krahas borxhit i detyrohet ndërmarrjes edhe kamatën ligjore të borxhit.

Gjithashtu fermeri detyrohet të bëjë kompensimin e dëmeve eventuale të shkaktuara me rastin e ujitjes në asetet e Ndërmarrjes.

IV Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata lidhet me kohë të caktuar për një sezon të ujitjes dhe detyrimet përfundojnë me kalimin e afatit të kontratës.

V Kompetenca gjyqësore

Në rast kontesti, çështja juridike do të zgjidhet nga gjykata kompetente.

VI Hyrja në fuqi

Fermeri është i njoftuar dhe pranoj të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit që rrjedhin nga kontrata dhe rregullorja për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes e cila është pjese përbërës e kësaj kontrate.

Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj kontrate janë meritore vetëm në formën e shkruar.

Kontrata është hartuar në 4 (katër) ekzemplar, prej të cilave një e merr shfrytëzuesi.

Data dhe vendi: _____

Nr.tel.i fermerit: _____

Për Ndërmarrjen:

Fermeri:



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo

Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

_____ nga _____
Emri (emri i prindit) dhe Mbiemri (vendbanimi dhe adresa)

I.nj _____ Pronar apo qiramarrës, Komuna: _____, zona
kadastrale: _____ ngastra nr. _____, më sipërfaqe prej _____ ha,
NIF (Numri Identifikues i Fermerit) _____ në vazhdim Fermeri,

Në bazë të dispozitave të nenit 1 dhe 3 të Rregullores për Shfrytëzimin e Sistemit të Ujitjes, lidhin:

**KONTRATË
PËR SHFRYTËZIMIN E PAJISJEVE MOBILE PËR UJITJE**

I

Objekt i kontratës

Objekt i kontratës është dhënia në shfrytëzim e pajisjeve për ujitje në vazhdim pajisjet/lateralin, respektivisht marrja e tyre në shfrytëzim.

II

Detyrimet e Ndërmarrjes për pajisjet

Ndërmarrja ia jep në gjendje të rregullt pajisjet me specifika të veçanta fermerit për shfrytëzim për ujitjen e kulturave bujqësore.

Me pajisje nënkuptohet kompleti i gypave të aluminit së bashku me lidhëse, spërkatës, mbyllës dhe çelës të hidrantit të numëruara në specifika.

Specifika e nënshkruar nga palët është pjesë përbërës e kontratës.

III

Detyrimet e fermerit për pajisje

Fermeri pajisjet do t'i shfrytëzoj vetëm për ujitjen e sipërfaqeve të kontraktuara dhe nuk mund t'i përdorë për qëllime tjera, dhe atë nga data: _____ deri më _____.

Fermeri detyrohet që gjatë shfrytëzimit t'i përdorë në mënyrë profesionale dhe t'i ruaj ato nga dëmtimet.

Në rast të dëmtimit eventual, fermeri detyrohet t'ia kompensoj ato ndërmarrjes në vlerën blerëse të tyre.

Fermeri nuk mund t'i tjetërsoj pajisjet dhe as t'i jep me qira dikujt tjetër, por të njëjtat duhet t'i kthej në afatin dhe kushtet e parapara në këtë kontratë.

Nëse fermeri, deri në skadimin e afatit kontraktues (31 Mars) nuk i kthen pajisjet nga sezoni paraprak, dhe për sezonin e ardhshëm nuk ka lidhë kontratë për ujitje, i njëjti detyrohet të paguaj ndërmarrjes kamatën ligjore të vlerës reale të pajisjeve, duke filluar nga dita e mbarimit të sezonit të ujitjes dhe atë nga data 01.10 të vitit të kaluar.

IV Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata lidhet në kohë të caktuar, për një sezon të ujitjes, nga data 01.06 deri me datë 30.09.20__ __

Nëse fermeri bënë vazhdimin e kontratës së ujitjes për sezonën vijuese i njëjti nuk detyrohet t'i kthej pajisjet, por me kontratë të re i vazhdohet e drejta e shfrytëzimit edhe për sezonin tjetër.

V Shkëputja e kontratës

- Ndërmarrja, në çdo moment, njëanshëm mund ta shkëput kontratën nëse:
 - Fermeri edhe pas vërejtjes vazhdon shfrytëzimin e pajisjeve në kundërshtim me dispozitat e kontratës
 - Fermeri shfrytëzon për destinime tjera, dhe
 - Fermeri për shkaqe të tjera nuk mund t'i shfrytëzoj ato

Pranim-dorëzimi i pajisjeve për ujitje bëhet me procesverbal për gjendjen, kohën dhe sasinë e dorëzuar.

VI Veprimi juridik i shkëputjes së kontratës

Me skadimin e kontratës (përfundimit të sezonës), fermeri, detyrohet Ndërmarrjes t'ia kthej pajisjet në gjendje të rregullt.

Me rastin e pranim-dorëzimit, hartohet procesverbali për gjendjen e pajisjeve, sasinë dhe kohën e dorëzimit.

VII Kompetenca gjyqësore

Në rast kontesti, çështja i kalohet gjykatës kompetente.

VIII Hyrja në fuqi

Para nënshkrimit të kontratës, fermeri, u njoftua dhe i pranoi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga rregullorja për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe dispozitat e kontratës.

Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

Ndryshimet dhe plotësimet e kontratës, janë meritore vetëm në formën e shkruar.
Kontrata është e hartuar në 4 (katër) ekzemplar identik, një prej tyre e merr fermeri

Data dhe vendi: _____

Nr.tel.i fermerit: _____

Fermeri:

Për Ndërmarrjen:
